



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E
MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:

KUALIFIKIMI PROFESIONAL “MBËSHTETJE E
PËRDORUESVE TË TIK”

(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)

Tiranë, 2024

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve për Kualifikimin Profesional “Mbështetje e përdoruesve të TIK”, me strukturë 2+2, për provimin e detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmblendhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, Niveli II i KSHK-së (klasa 10 dhe 11-të);
- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Mbështetje e përdoruesve të TIK”, Niveli IV i KSHK-së (klasa e 12-të dhe 13-të).
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 27, datë 12.12.2023 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të “Teorisë profesionale të integruar”, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Qëllimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale është vlerësimi i të nxënësve dhe arritjeve si dhe përzgjedhjen e nxënësve për arsimim të mëtejshëm.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar të “Teorisë profesionale të integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për Kualifikimin Profesional “Mbështetje e përdoruesve të TIK” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Ky program përmban rreth **30%** të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve të kulturës profesionale. Në këtë program janë përfshirë ato lëndë, të cilat përbëjnë bazën kryesore dhe thelbësore për formimin profesional të nxënësve.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**” në kuadrin e provimit të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për Kualifikimin Profesional “**Mbështetje e përdoruesve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)**”, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

1. Bazat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, kl. 10 dhe kl.11.
2. Arkitekturë kompjuteri dhe rrjetesh, kl. 12.
3. Programim në WEB, kl. 12.
4. Administrim sistemesh shfrytëzimi, kl. 13.
5. Siguria kibernetike, kl. 13.

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr.	Lëndët	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Bazat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit	53	19
2	Arkitekturë kompjuteri dhe rrjetesh	75	27
3	Programim në WEB	50	17
4	Administrim sistemesh shfrytëzimi	63	23
5	Sigura kibernetike	38	14
	TOTALI	279	100%

Temat sipas lëndëve janë:

a) “**Bazat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit**”, kl. 10 dhe kl. 11:

(53 orë)

Tema 2	Njohuritë e teknologjive konkrete që përdoren së fundmi në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.	5 orë
Tema 3	Sistemet e numërimit dhe paraqitja e informacionit.	2 orë
Tema 4	Gjeneratat e kompjuterave dhe dallimi midis tyre.	2 orë
Tema 6	Parimet bazë të punës së një kompjuteri (<i>Hardware – Software</i>)	3 orë
Tema 9	Pjesët kryesore të <i>PC</i> , funksionet dhe karakteristikat e tyre.	3 orë
Tema 10	Njësia qendrore dhe pjesët përbërëse.	2 orë

Tema 11	Periferikët dhe pajisjet hyrëse dhe dalëse të informacionit .	2 orë
Tema 12	Memorja e përkohëshme(RAM) dhe e përhershme (ROM), skemat, njësitë matëse dhe montimi i moduleve të RAM-it.	3 orë
Tema 15	Procesori, gjeneratat, llojet dhe njësitë matëse, montimi i procesorit dhe i ftohësit.	3 orë
Tema 19	Lidhja e elementeve me <i>motherboard</i> -in (fishat e ushqimit, kabllot e të dhënave, kontrollerat - <i>IDE, SCSI, SATA</i>).	2 orë
Tema 21	Lidhja e aksesorëve të një kompjuteri – identifikimi nga sistemi operativ dhe instalimi.	3 orë
Tema 22	Proçesi i startimit të kompjuterit (<i>BIOS</i> -i).	2 orë
Tema 2	Rrjetat e informacionit dhe komunikimit, protokollet, teknologjitë.	3 orë
Tema 3	Teknologjitë closed-source dhe open-source.	2 orë
Tema 4	Bazat e të dhënave dhe sistemet e menaxhimit të bazave të të dhënave.	3 orë
Tema 5	Sistemet e përpunimit të informacionit me shumë procesor.	4 orë
Tema 7	Cloud computing	3 orë
Tema 8	Sistemet GIS.	3 orë
Tema 9	Element të inteligjencës artificiale dhe të machine learning.	3 orë

b) “Arkitekturë kompjuteri dhe rrjetesh”, kl. 12:

(75 orë)

Tema 2	Struktura e <i>Motherboard</i> -it dhe furnizimi me energji.	4 orë
Tema 6	Hard disqet dhe pajisjet ruajtëse. <i>SATA, PATA, RAID, HDD masterslave</i> . Memoret e jashtme	6 orë
Tema 7	Pajisjet hyrëse dhe dalëse. Teknologjitë e reja te pajisjeve <i>I/O</i> .	4 orë
Tema 8	Portat, kabllot, konektorët dhe përshtatësit.	4 orë
Tema 9	Montimi, konfigurimi dhe startimi i kompjuterit.	5 orë
Tema 10	Laptopët dhe pajisjet e tjera të lëvizshme.	4 orë
Tema 11	Printerat, skanerat, videoprojektorët.	4 orë
Tema 12	Sistemet e Shfrytëzimit të kompjuterave personal. Llojet dhe versionet. Instalimi konfigurimi dhe krijimi i llogarive.	5 orë
Tema 13	Përditësimi dhe <i>Upgrade</i> -imi i sistemeve. Monitorimi dhe mirëmbajtja	4 orë
Tema 14	Përdorimi i sistemeve te shfrytëzimit me licensa dhe <i>opensource</i> . Dallimet ndërmjet tyre.	4 orë
Tema 15	Rrjetat <i>LAN</i> . Llojet, topologjitë dhe modelet e rrjetave kompjuterike.	4 orë
Tema 16	Modeli e komunikimit në rrjet dhe funksionet e shtresave. (<i>OSI, TCP/IP</i>)	5 orë
Tema 17	Pajisjet e rrjetit. Montimi i pajisjeve aktive ne <i>rack</i>	5 orë
Tema 18	Protokollet e komunikimit. Protokoll <i>Ipv4</i> dhe <i>Ipv6</i> .	6 orë
Tema 19	Skemat e adresimit në rrjet. Caktimi i adresave <i>IP</i> . <i>Subnet</i> -imi	6 orë
Tema 20	Rrjetat <i>WLAN</i> . Komunikimi në <i>wireless</i> .	5 orë

c) “Programim në WEB”, kl. 12:

(50 orë)

Tema 1	Struktura e <i>HTML</i> dhe stilimi me <i>CSS</i>	6 orë
Tema 2	Hyrje në <i>JavaScript</i>	5 orë
Tema 3	Struktura e kontrollit	5 orë
Tema 5	Objektet. Përcaktimi i objekteve në <i>JavaScript</i>	3 orë
Tema 6	Vektorët	3 orë
Tema 7	Funksionet	4 orë
Tema 8	DOM	3 orë
Tema 10	Tipet e të dhënave, operatorët, variablat	3 orë
Tema 11	Struktura e kontrollit	5 orë
Tema 12	Funksionet mbi stringjet dhe funksionet rekursive	6 orë
Tema 13	Komunikimi me Browser	3 orë
Tema 15	Cookie-t dhe Sesionet	4 orë

d) “Administrim sistemesh shfrytëzimi”, kl. 13:

(63 orë)

Tema 1	<i>Boot</i> -imi i Sistemit <i>Linux</i> (<i>BIOS</i> , <i>MBR</i> , <i>LILO</i>)	3 orë
Tema 2	Menaxhimi i diskut, krijimi i particioneve. Menaxhimi i volumeve logjike	3 orë
Tema 4	Pasqyrimi (<i>MIRRORING</i>) i volumeve logjike	3 orë
Tema 5	Fshirja e volumeve logjike, fizike dhe volumeve të grupeve	3 orë
Tema 7	Menaxhimi i userave. Ndryshimi i <i>usera</i> -ve, komanda <i>SUDO</i>	4 orë
Tema 8	Modeli <i>TCP/IP</i> për administrimin në <i>Linux</i>	3 orë
Tema 13	Krijimi, menaxhimi dhe ruajtja e disk image për shpërndarje	3 orë
Tema 14	Konfigurimi i disqeve dhe volumeve. Implementimi I <i>server storage</i>	3 orë
Tema 15	Instalimi dhe konfigurimi i <i>DNS Servers</i> . Krijimi dhe konfigurimi i <i>DNS Zonës</i> , Rekordet dhe politikat e <i>DNS</i>	3 orë
Tema 16	<i>Windows Server</i> . Llojet e sistemeve <i>Windows Server</i> dhe kërkesat standarde për instalim dhe përdorim.	3 orë
Tema 17	Menaxhimi i <i>Windows Server Core</i> duke përdorur komandat. Rolet dhe veçoritë	4 orë
Tema 19	Instalimi dhe konfigurimi i <i>Active Directory Domain Services</i>	3 orë
Tema 20	Instalimi dhe konfigurimi i <i>domain controllers</i>	3 orë
Tema 21	Krijimi dhe menaxhimi i llogarive të përdoruesve dhe kompjuterëve në <i>Active Directory</i>	4 orë
Tema 22	Krijimi dhe menaxhimi i grupeve dhe njësisive organizative në <i>Active Directory</i>	4 orë
Tema 23	Konfigurimi i autentifikimit të shërbimeve dhe politikat e llogarive	3 orë
Tema 24	Krijimi dhe menaxhimi i politikave të grupeve	3 orë
Tema 26	Instalimi, konfigurimi dhe implementimi i <i>Hyper-V</i> Konfigurimi i makinës virtuale	4 orë
Tema 28	Administrimi në distance	4 orë

e) “Siguria kibernetike”, kl. 13:

(38 orë)

Tema 1	Hyrje në sigurinë kibernetike. Konceptet kryesore.	2 orë
Tema 2	Rëndësia e sigurisë kibernetike.	2 orë
Tema 3	Të dhënat personale. Mbrojtja e tyre.	3 orë
Tema 4	Siguria në internet.	3 orë
Tema 6	Vlerësimi i riskut, shkalla e riskut, matrica e riskut.	3 orë
Tema 7	Standardet e sigurisë kibernetike: <i>CIA, Yll</i> dhe <i>Parkerian</i> .	6 orë
Tema 8	Konceptet e menaxhimit të sigurisë kibernetike.	4 orë
Tema 10	Planifikimi strategjik i sigurisë së informacionit.	4 orë
Tema 11	Cikli jetësor i sigurisë së informacionit.	3 orë
Tema 12	Planet dhe politikat e sigurisë. Nivelet e planifikimit.	4 orë
Tema 14	Kontrollet e sigurisë kibernetike.	2 orë
Tema 17	Matja e sigurisë/ metrika.	2 orë